

LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 11: Prill - Qershor 2023



Të nderuar prindër, Të dashur kolegë e nxënës,

Kemi mbyllur me sukses edhe një tjetër vit shkollor, i cili ka qenë plot me: punë mësimore- edukative, aktivitete, konkurse, programe jashtëshkollore, projekte, ekskursione e njëkohësisht me plot sfida, të cilave ia kemi dalë ti përballojmë me mjaft sukses.

Në përfundim të këtij viti shkollor, dua të falenderoj të gjithë prindërit për besimin që na kanë dhënë për edukimin e fëmijëve të tyre në shkollën tonë, për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e treguar në çdo situatë, si dhe të gjithë ata që kanë kontribuar për realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara këtë vit shkollor.

Një falenderim shkon edhe për gjithë mësuesit, për punën plot përkushtim me nxënësit e që janë gjithnjë të gatshëm e të pakursyer të japin më të mirën e tyre për të arrirë rezultate të larta me nxënësit.

Veçanërisht për t'u përgëzuar janë edhe nxënësit tanë, të cilët me punën, përkushtimin dhe arritjet e tyre në mësim, në projekte, në

konkurse, në aktivitete të ndryshme, por edhe me rezultatet e tyre në provimet kombëtare, na kanë bërë krenarë ne edhe familjet e tyre.

Këtë vit shkollor kemi shënuar disa arritje, nga të cilat po përmend vetëm disa:

- Disa bashkëpunime me shkollën AMARO TAN.
- Disa aktivitete sportive me shkollën nga Pogradeci, Prrenjasi, Belshi, etj.
- Rezultate të larta në provimet e maturës 8,6 në Letërsi dhe 9,2 në Anglisht, 7,3 në Matematikë dhe 8,6 në Lëndët me Zgjedhje.
- Rezultate të larta në provimet e Lirimit, 9,2 në Gjuhë shqipe, 9,04 në Matematikë dhe 9,8 në Anglisht.
- Vendi i dytë në olimpiadën rajonale "Rroke Shkencën".
- 36 Fitues në olimpiadën ndërkombëtare Kangaroo Linguistic.
- 13 fitues në olimpiadën ndërkombëtare "Kangaroo Mathematics".
- 6 fitues në olimpiadën ndërkombëtare Teen Eagle në anglisht.
- Bashkëpunime me AMARO TAN, Policinë e Shtetit, Qendrën e kujdesit shëndetësor si

dhe me institucione të tjera ndërkombëtare si, Teach Beyond etj.

- 5 vite bashkëpunim me B@S.
- 5 vite bursa "Jorgji Jajçari".
- Klubet e pasdites për klasat VI-IX.
- Vullnetare nga Weltwerts në programe të ndryshme në Nehemiah Gateway Albania.
- Praktikantë nga LMU – Universiteti i Mynihut.
- Takime individuale dhe në grupe me prindër, etj.
- Disa projekte sociale në bashkëpunim me qendrën tonë sociale.

Jemi duke punuar intesivisht për mbylljen e dokumentacionit të vitit shkollor dhe SMIP dhe për realizimin me sukses të Ceremonisë së Diplomimit për Maturën 2023.

Ju faleminderit të gjithëve për bashkëpunimin tuaj dhe ju urojmë pushime verore të mbaral!

**Me respekt,
Elona Rira
Drejtoresh e Shkollës NEHEMIA**

elona.rira@ng.team

Sistemi NCTS (Nehemiah Credits Transfer System), Shkolla NEHEMIA

Sqarim:	Kreditet NCTS
Pjesëmarrja në kopsht me më pak se 10 mungesa në muaj:	+ 0.5
Nota 9 në testet e drejtorisë merr NCTS (AF, AMU, AML)	+ 1
Nota 10 në testet e drejtorisë merr NCTS (AF, AMU, AML)	+ 2
Në konkurset kombëtare Vendi 1, - 2, - 3	+ 3, + 2, + 1
Në konkurset ndërkombëtare Vendi 1, - 2, - 3	+ 6, + 5, + 4
Certifikatat e gjuhëve të huaja për çdo nivel (A1 - C1)	+ 1
Certifikatat për përdorimin e programeve kompjuterike (Windows)	+ 3
Angazhime me punë vullnetare (për çdo 10 orë)	+ 1
Anëtarësim aktiv në programin Royal Rangers (ROR) (në muaj)	+ 0.5
Pagesë e rregullt (çdo muaj ose në fillim të çdo periudhe):	+ 0.5
Pagesa e plotë (vjetore)	+ 6
Ardhja me vonesë (në 3 raste)	-1
Mungesa pa arsye (ditore)	-2
Përdorimi i palejuar i telefonit (1 rast)	-3
Largimi nga kampusi pa djeninë e mësuesit kujdestar (1 rast)	-4
Sjellja në kampus e personave të pa autorizuar (1 rast)	-6
Qortim nga komisioni i etikës	-5
Këshillim nga komisioni i etikës	-10
Vërejtje me shkrim	-15
Paralajmërim për ulje të notës në sjellje	-20
Ulje e notës në sjellje	-25
Kontribut i detyruar në shërbim të shkollës	-30

Shënim:

Pjesëmarrja në kopsht duhet të jetë më pak se 10 mungesa në muaj për përfitimin e krediteve.
Lëndët sipas cikleve në testet e drejtorisë janë si më poshtë:
EMS - Gjuhë Shqipe, Ditari, Anglisht, Gjermanisht, Matematikë
MSC - Gjuhë Shqipe, Anglisht, Gjermanisht, Matematikë, Fizikë, Kimi dhe Biologji
HSC - Gjuhë Shqipe, Anglisht, Gjermanisht, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Letërsi
Në konkurset kombëtare Vendi i I - 3 NCTS, Vendi i II - 2 NCTS dhe Vendi i III - 1 NCTS
Në konkurset ndërkombëtare Vendi i I - 6 NCTS, Vendi i II - 5 NCTS dhe Vendi i III - 4 NCTS
Certifikatat e gjuhëve të huaja fillojnë nga niveli A1 - 1 NCTS, A2 - 3 NCTS, B1 - 6 NCTS, B2 - 9 NCTS & C1 - 12 NCTS
Certifikatat për përdorimin e programeve kompjuterike Word, Excel, Powerpoint, Access, Outlook
Angazhimi me punë vullnetare në 'Programi Social' (SOS), "Përgjegjësia Sociale" & "Punë në komunitet"
Pagesë e rregullt mujore brenda datës 5 të çdo muaji si parapagesë për muajin pasardhës 0.5 NCTS/muaj
Pagesë e plotë për të gjithë vitin shkollor në fillim të vitit shkollor 6 NCTS / Vit

Zbritja e NCTS do të bëhet sipas rasteve të parashikuara më lart dhe të protokolluara nga mësuesi kujdestar dhe komisioni i etikës dhe/ose disiplinës.
NCTS nuk mund t'i kalohen një personi apo shkolle tjetër jashtë NEHEMIA.
Në rast se një nxënës largohet nga shkolla, shkolla do i mbartë kreditet e fituara nga nxënësi për kohën që ai ka frekuentuar shkollën deri në 4 vite nga momenti i largimit. Pas kësaj kohe ato do të zerohen edhe nëse nxënësi rikthehet në shkollë.
Ky sistem do të rishikohet nga Drejtoria e Shkollës çdo 5 vjet.
Ky informacion shpërndahet tek të gjithë prindërit/nxënësit e shkollës NEHEMIA
Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni me Sekretarinë e Shkollës NEHEMIA.

Tarifat për vitin shkollor 2023-2024

Tarifa vjetore pa reduktim nga NCTS

	Kopshti	Arsimi Fillor	Arsimi 9-vjeçar	Gjimnazi
Tarifa vjetore	136.190,-lekë	169.180,-lekë	188.150,-lekë	233.100,-lekë
Mësimi	85.000,-lekë	115.000,-lekë	125.000,-lekë	155.000,-lekë
Transport	18.300,-lekë	18.300,-lekë	18.300,-lekë	18.300,-lekë
Ushqim	32.890,-lekë	35.880,-lekë	44.850,-lekë /Blerje sipas menisë ditore	59.800,-lekë/ Blerje sipas menisë ditore

DATA TË RËNDËSISHME:

- Ceremonia e Diplomimit, Matura 2023, më 06.07.2023
- Ceremonia e hapjes së vitit të ri shkollor 2023-2024 më 04.09.2023
- Mësimi për vitin shkollor 2023-2024 fillon më 06.09.2023

Skano për të lexuar online!



Shkolla NEHEMIA

Nehemia 7304 Buçimas,
Pogradec Albania

Tel.: +355 83 600 403

Fax: +355 83 600 405

shkolla-nehemia@ng.team

Na ndiqni në facebook:

www.facebook.com/NehemiahGateway